



Raport
1 Shtator 2017 - 15 Mars 2018

MONITORIMI I AUTONOMISE DHE TRANSPARENCES FINANCIARE TE UNIVERSITETEVE PUBLIKE



QENDRESA
QYTETARE



TASK
FORCA
STUDENTORE

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

Përbajtja

1. Hyrje

2. Gjetjet kryesore

3. Analiza e transaksioneve të universiteteve publike

- 3.1 Kategoria “Shpenzime Personeli”
- 3.2 Kategoria “Investime”
- 3.3 Kategoria “Blerje mallrash”
- 3.4 Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”
- 3.5 Kategoritë “Transferta dhe Subvencione” dhe “Të tjera”

4. Transparenca e IAL-ve

5. Rekomandime

6. Shtojca

- 6.1 Fishat e monitorimit të Programeve të Transparencës
- 6.2 Përgjigje zyrtare e Universitetit të Tiranës me tarifat përkatëse
- 6.3 Vendim i Këshillit të Administrimit të Universitetit të Tiranës “Për tarfiat”
- 6.4 Ankimim ndaj refuzimit për dhënie informacioni ndaj Universitetit “Aleksandër Xhuvani”



Në kuadër të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ndryshimeve që institucionet e arsimit të lartë pësuan sa i takon menaxhimit finansiar dhe administrimit, Qëndresa Qytetare monitoroi tre universite publike me fokus investimet dhe nivelin e transparencës së tyre në raport me publikun dhe studentët për periudhën 1 Shtator 2017 deri më 15 Mars 2018.

Universitetet e përgjedhura për këtë monitorim ishin: Universiteti i Tiranës, Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu" dhe Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".



Ky monitorim shërben për të hedhur dritë mbi mënyrën se si shpenzohen të ardhurat që grumbullohen nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat që vijnë nga buxheti i shtetit. A reflektohen nevojat reale të studentëve dhe godinave apo kemi të bëjmë më një administrim jo efektiv të buxhetit vjetor? Grupi i monitoruesve shfrytëzoi dhe gërvshetoi një sërë burimesh të informacionit për të mos krijuar konfuzion ose paqartësi në paraqitjen e të dhënave.



Përvec shqyrtimit të të dhënave të përfituar nga Open Data dhe transaksionet e thesarit, 20 kërkesa për informacion drejtuar universitetëve të përgjedhura u dërguan nga grupi i punës i përbërë nga anëtarët e Task Forcës Studentore në lidhje me buxhetin, investimet dhe fatin e tarifave të studentëve. Pjesë e këtij procesi ishte edhe një metodologji specifikë e hartuar për të matur nivelin e transparencës së paraqitur në faqet zyrtare të universitetëve dhe stendat fizike të vendosura në ambientet e tyre dhe respektimin e ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit.



2 .GJETJET KRYESORE



Shpenzimet e Universitetit të Tiranës i cili është dhe Universiteti më i madh publik në Shqipëri për periudhën Shator 2017 – Prill 2019 janë rreth 4.5 herë më pak se Universiteti i Durrësit dhe rreth 3 herë më pak se Universiteti i Elbasanit. Kjo situatë ka ardhur si pasojë e ngërçit të krijuar ndërmjet Rektorit dhe Bordit të Administrimit, situatë e cila u shoqërua edhe me protesta për pagat e pedagogëve, mungesë investimesh dhe bursash për periudhën në fjalë.

90% e buxhetit per
paga ne nje person

PAGA BAZË

O LEKË
STUDIME
& KËRKIME

Sa i përket nënkategori "Paga bazë", ajo që bie në sy është fakti se Universiteti i Elbasanit ka bërë vetëm një transaksion për pagat përbledhëse me vlerë 22,430,269 lekë ndërkohë që pjesën tjeter të këtyre transaksioneve me vlerë 152,707,601 lekë për pagën bazë i ka kryer kundrejt një individi me emrin F.Q.

Nga monitorimi i transaksioneve rezulton se tre universitetet publike janë më larg shkencës dhe më pranë luksit të zyrave, pasi nuk kanë shpenzuar asnjë vlerë për nënkategori studime dhe kërkime përgjatë këtij monitorimi 7 mujor të kryer nga Qëndresa Qytetare, që do të thotë se paratë e tarifave të studentëve janë shpenzuar deri në 15.000.000 lekë nga UAMD për pajisje zyrash për titullarët dhe deri në 39.268.777 lekë nga UT për likuidime të punonjësve të hequr padrejtësisht nga puna për faj të titullarëve. Ky fakt tregon se kemi universitete të pasura por administratorë që nuk e duan arsimin.




Sa i përket shpenzimeve për blerje mallrash, Universiteti i Durrësit jo vetëm që kryen pagesat më të larta për energjinë elektrike por nëpërmjet një transaksi me vlerë **900,000** lekë ka kryer pagesë ndaj një përfituesi që nuk është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me përshkrimin "10111502018 Universiteti 'A. Moisiu' Durrës paguar shpenzime energji janar 2018 Faturë nr 248123731 dt 31.01.2018 Kontratë A102307" dhe ky veprim është vendosur në kategorinë e shpenzimeve të thesarit: Shpenzime për aktivitete sociale për personelin dhe jo në nënkategoriën energji elektrike.



Universiteti "Aleksandër Xhuvani" ka kryer një transfertë me vlerë **319,440** lekë kundrejt përfituesit "Alban Tirana NASCENDO AL" me përshkrim fature "1011099 Universiteti Alkesander Xhuvani abonim karte TV urdher nr 304 dt 22.12.2017 ft nr 393544435" në kategorinë shërbime të printimit dhe publikimit. Së pari, studentët duhet të informohen se paratë e tyre po shkojnë për një shpenzim luksi për zyrat e drejtuesve sic është abonimi tv, ndërkohë që ambientet universitare nuk kanë internet falas, së dyti kjo vlerë nuk përkon me vlerat reale të tregut të operatorëve dixhitalë dhe së treti, ky transaksion është kategorizuar në një kategori jopërfshirëse sic është ajo e publikimeve.



Nga monitorimi janë evidentuar pagesa të larta që universitetet shpenzojnë për sigurimin e ndërtesave, nga 10.780.030,00 lekë UAMD deri në 13.919.080,00 Universiteti i Elbasanit, shifra të cilat nuk justifikojnë shërbimin e sigurimit për ndërtesën apo për pajisjet që ato kanë, pasi zënë një shumë të konsiderueshme që buron nga tarifat e studentëve apo buxheti i shtetit. E vetmja gjë që studentët shohin çdo ditë nga gjithë kjo shumë e shpenzuar është një roje sigurie tek dyert e godinave, ndërkohë që Universiteti i Tiranës, i cili ka më shumë pajisje dhe më shumë godina se dy të parët, shpenzon vetëm 4.404.109,00 lekë në vit për ruajtje dhe sigurim të ndërtesave.



Nga 20 kërkesat për informacion të dërguara nga Qëndresa Qytetare dhe studentët, asnjë nga universitetet nuk dërgoi përgjigjen në afat, ndërsa Universiteti i Tiranës në përgjigje të katër kërkesave dërgoi një faturë me vlerën 1000 lekë të reja për ta paguar në këmbim të këtij shërbimi, me arsyetimin se neni 13 i ligjit për të drejtën e informimit i lejon të vendosë një tarifë të tillë në këmbim të informacionit. Refuzimi i përgjigjeve dhe kjo tarifë u ankimuan pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit për të proceduar me masat administrative përkatëse për titullarët dhe koordinatorët për të drejtën e informimit.

3. Analiza e transaksioneve të universiteteve publike

Gjatë periudhës së marrë në considerate, universitetet e përzgjedhura në monitorim kanë bërë përkatësisht në total transaksione me këto vlera:

Universiteti i Tiranës:

84,400,661 All

Universiteti i Durrësit

“Aleksandër Moisiu” :


384,891,203 All

Universiteti i Elbasanit

“Aleksandër Xhuvani” :

262,964,568 All

**Shpenzimet (në vlerë) sipas Universiteteve
periudha 01.09.2017 -15.03.2018**



Ajo çfarë bie në sy është se shpenzimet e Universitetit të Tiranës, i cili është dhe Universiteti më i madh publik në Shqipëri janë shumë herë më pak se ato të Universitetit të Durrësit apo atij të Elbasanit. Përkatësisht rreth 4.5 herë më pak se Universiteti i Durrësit dhe rreth 3 herë më pak se Universiteti i Elbasanit. Kjo situatë mendohet të ketë ardhur si pasojë e ngërçit të krijuar ndërmjet Rektorit dhe Bordit të Universitetit të Tiranës, e cila u shoqërua edhe me protesta për pagat e pedagogëve. Nëse do flasim për numër transaksionesh është Universiteti i Elbasanit që megjithëse me vlerë totale rreth 3 herë më të madhe se Universiteti i Tiranës ka kryer më pak transaksione në numër, 160 kundrejt 171 të Universitetit të Tiranës dhe 277 të atij të Durrësit.

Grupi i monitoruesve ka identifikuar një sërë transaksionesh të ndara sipas kategorive të cilat nuk përputhen as me vlerat normale të pagesave as me nevojat që mund të ketë një universitet publik parë në raport me buxhetin e tij total. Sipas kategorive të shpenzimeve universitetet kanë bërë këto shpenzime :

	Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
II	Shpenzime personeli	33.983.446	235.294.326,00	187.049.583,00
III	Investime	0	91.641.226,00	8.023.800,00
IV	Blerje mallrash	4.717.514	26.784.170,00	20.323.364,00
V	Sigurimi i shërbimeve	5.164.281	15.992.791,00	28.473.266,00
VI	Transferta dhe Subvencione	1.266.643	130.826,00	24.671,00
VII	Të tjera	39.268.777	15.047.864,00	19.069.884,00
Totali		84.400.661	384.891.203,00	262.964.568

3.1 Kategoria “Shpenzime Personeli”

Për shpenzime personeli në total Universiteti i Tiranës ka shpenzuar 33,983,446 lekë, Universiteti i Durrësit 235,294,326 lekë dhe ai i Elbasanit 187,049,583 lekë. Ajo që vëmë re në shpenzimet brenda kësaj kategorie është që Universiteti i Elbasanit ndryshe nga dy Universitet e tjera nuk ka bërë asnjë pagesë për nënkatgorinë “paga me kontratë për kohë të kufizuar”. Universiteti i Tiranës nuk ka bërë asnjë pagesë për anëtarët e Bordit Administrativ, ndërkohë që është Universiteti i Durrësit ai që ka kryer pagesat më të larta për Bordin Administrativ me plot 3,379,940 lekë.

Në nën katgorinë “Paga Bazë” Universitet kanë shpenzuar përkatesisht : 26,492,011 lekë Universiteti i Tiranës, 202,342,849 lekë Universiteti i Durrësit dhe 175,137,870 lekë Universiteti i Elbasanit.

Ajo që bie në sy për këtë nënkatgori është fakti se Universiteti i Elbasanit ka bërë vetëm një transaksion për pagat përbledhëse me vlerë 22,430,269 lekë ndërkohë që pjesën tjetër të këtyre transaksioneve me vlerë 152,707,601 lekë për pagën bazë i ka kryer kundrejt një individi me emrin Filip Qose, ku mund të përmendim transaksionin më të madh për pagat të kryer nga tre universitetet me vlerë **40,462,176** lekë me përshkrim fature: “1011099 Universiteti Alkesander Xhuvani paga Filip Qosja nr 033378638”. Përvec kësaj anomalie personit në fjalë i ka kaluar edhe një transaksion si pagesë pjesë bordi prej 512,100 lekësh. Për periudhën Shtator 2017 - Mars 2018, Universiteti i Elbasanit ka kryer 7 transaksione me vlerë 153,219,701 lekë për z. Filip Qosja, person i akuzuar për korruption në krye të detyrës në vitin 2013 kur mbante pozicionin e drejtorit ekonomik të universitetit.

Kategori/Nënkatgori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit "Aleksander Moisiu"	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
Shpenzime personeli	33.983.446,00	235.294.326,00	187.049.583,00
Paga	26.492.011,00	202.342.849,00	175.137.870,00
Honorare + Të tjera shpërblime për personelin	6.086.415,00	11.088.295,00	31.642,00
Paga me kontratë për kohë të kufizuar	1.327.695,00	18.300.447,00	
Dieta udhëtime	77.325,00	182.795,00	3.299.741,00
Pagesa anëtarët e bordit administrativ	0,00	3.379.940,00	8.580.330,00

3.2 Kategoria “Investime”

Për kategorinë Investime Universiteti i Tiranës nuk ka ekzekutuar asnjë transaksion për periudhën shtator 2017 – mars 2018, pavarësisht se është unviersiteti që mbulon mbi 50 % të të ardhurave nga tarifat e studentëve. Ky është rasti kur ngërçi mes Bordit të Administrimit dhe Rektoratit për shkak të mosmarrëveshjeve dhe mungesës së akteve nënligjore shteruese sjell pasoja negative për shërbimet ndaj studentëve dhe arsimin e lartë në tërësi.

Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu” ka shpenzuar në këtë periudhë 91,641,226 lekë, shifër kjo e ndikuar nga vlera prej 76,638,496 lekë paguar Kevin Construction për ndërtimin e godinave shkollore apo kampusit të ri universitar, ku fatura kryesisht është mbartur nga kontrata të viteve të mëparshme. Gjithashtu Universiteti i Durrësit ka shpenzuar plot 15,000,000 lekë për pajisje zyre dhe orendi të tjera kundrejt 75,000 lekë të shpenzuara nga Universiteti i Elbasanit. Ndërkohë që Universiteti i Elbasanit është i vetmi që ka kryer pagesa prej 7,948,800 lekësh për nënkategoriin mjete dhe pajisje teknike, për pajisje laboratorike.

Ajo që bie në sy nga të tre universitetet është fakti se janë më larg shkencës dhe më pranë luksit të zyrave, pasi nuk kanë shpenzuar asnjë vlerë për nënkategoriinë studime dhe kërkime përgjatë këtij monitorimi 7 mujor të kryer nga Qëndresa Qytetare, që do të thotë se paratë e tarifave të studentëve janë përkthyer në pajisje zyrash dhe likuidim kontrataш të viteve të kaluara për ndërtime dhe jo në kontribut real për studime dhe shkencë.

3.3 Kategoria “Blerje mallrash”

Në kategorinë Blerje mallrash Universiteti i Tiranës ka shpenzuar 4,717,514 All, Universiteti i Durrësit 26,784,170 dhe Universiteti i Elbasanit 20,323,364. Ajo çka vemë re është fakti se për energji elektriqe Universiteti i Tiranës ka shpenzuar shumë herë më pak, në vlerën 999,435 lekë kundrejt 9,014,936 lekë që ka shpenzuar Universiteti i Durrësit apo 4,270,626 lekë që ka shpenzuar Universiteti i Elbasanit, dhe pse Universiteti i Tiranës është i përbërë nga disa godina të ndryshme fakultetesh.

Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
Investime		91.641.226,00	8.023.800,00
Rikonstrukcion i ndërtesave shkollore	0,00	76.638.496,00	0,00
Pajisje pastrimi	0,00		0,00
Mjete transporti	0,00	2.730,00	
Mjete dhe pajisje teknike	0,00	0,00	7.948.800,00
Pajisje zyre dhe orendi të tjera		15.000.000,00	75.000,00
Studime dhe kërkime	0,00	0,00	0,00

Universiteti i Durrësit jo vetëm që kryen pagesat më të larta për energjinë elektrike por nëpërmjet një transaksi me vlerë 900,000 lekë ka kryer një pagesë ndaj një përfituesi që nuk është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me përshkrimin "10111502018U niversiteti 'A. Moisiu' Durrës paguar shpenzime energji janar 2018 Faturë nr 248123731 dt 31.01.2018 Kontratë A102307" dhe ky veprim është vendosur në kategorinë e shpenzimeve të thesarit: Shpenzime për aktivitete sociale për personelin dhe jo në nënkatgorinë energji elektrike.

Për nënkatgorinë Ujë është Universiteti i Elbasanit ai që ka kryer transaksione me vlerë shumë më të madhe se dy universitetet e tjera, 3,094,003 lekë kundrejt 293,150 lekë Universiteti i Tiranës dhe 209,124 Ali Universiteti i Durrësit. Universiteti i Tiranës nuk ka kryer asnjë shpenzim për nënkatgorinë kancelari ndërsa ai i Durrësit asnjë shpenzim për nënkatgorinë shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik që është dhe kategoria e shpenzimit për prodhimin e diplomave.

Kategori/Nënkategori	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
Blerje mallrash	4.717.514,00	26.784.170,00	20.323.364,00
Energji elektrike	999.435,00	9.014.936,00	4.270.626,00
Karburant dhe vaj		6.267.510,00	2.125.952,00
Ujë	293.150,00	209.124,00	3.094.003,00
Ngrohje + Pastrim	2.794.619,00	984.000,00	940.980,00
Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme		3.888.000,00	1.947.271,00
Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	247.423,00		359.880,00
Libra dhe publikime profesionale	48.456,00	5.982.600,00	1.243.250,00
Materiale dhe shërbime operative	150.504,00		2.463.368,00
Pajisje Informatike	183.927,00		2.723.400,00
Materiale të tjera		438.000,00	1.154.634,00

3.4 Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”

Në kategorinë e shpenzimeve për Sigurimin e Shërbimeve, Universiteti i Tiranës ka shpenzuar vlerën 5,164,281 lekë, Universiteti i Durrësit 15,992,791 lekë dhe Universiteti i Elbasanit 28,473,266 lekë. Ajo që bie në sy është fakti që Universiteti i Tiranës ka shpenzuar më shumë në nënkategori të telefonit dhe internet se dy universitetet e tjera, me vlerat përkatesisht Universiteti i Tiranës 601,502 All, Universiteti i Durrësit 248,394 All dhe Universiteti i Elbasanit 513,654 All. Megjithëse këto shpenzime arrijnë vlera të konsiderueshme krahasuar me abonimet standarte për zyra dhe familje, paradoksi qëndron në faktin se në asnjë nga këto tre universitete nuk ka as salla me internet falas për studentët as free wirelees në ambientet e tyre.

Universiteti Aleksandër Xhuvani ka kryer një transfertë me vlerë 319,440 All kundrejt përfituesit “Alban Tirana NASCENDO AL” me përshkrim fature “1011099 Universiteti Alkesander Xhuvani abonim karte tv urdher nr 304 dt 22.12.2017 ft nr 393544435” në kategorinë shërbime të printimit dhe publikimit.

Së pari, studentët duhet të informohen se paratë e tyre po shkojnë për një shpenzim luksi për zyrat e drejtuesve sic është abonimi tv, së dyti kjo vlerë nuk përkon me vlerat reale të tregut të operatorëve dixhitalë dhe së treti, ky transaksion është kategorizuar në një kategori jopërfshirëse si është ajo e publikimeve.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” ka paguar një transaksion me vlerë të vogël me përshkrinin “1011150 10111502017 UNIVERSITETI ‘A. MOISIU DURRES PAGUAR TEL CEL PER U.HOTIN GUSHT 2017 LIST PAGESE VKM 591 DT 10.07.2013” nën kategorinë e shpenzimeve në thesar “ Ilaçe dhe materiale të tjera mjekësore” , kategori e cila nuk ka lidhje fare me kategoritë e buxheteve të universiteteve.

Një detaj tjetër që bie në sy është pagesa e lartë që këto universitete shpenzojnë për sigurimin e ndërtimesave, nga 10.780.030,00 lekë UAMD deri në 13.919.080,00 Universiteti i Elbasanit, shifra të cilat nuk justifikojnë shërbimin e sigurimit për ndërtesën apo për pajisjet që ato kanë, pasi zënë një shumë të konsiderueshme që buron nga tarifat e studentëve apo nga buxheti i shtetit.

E vjetmja gjë që studentët shohin cdo ditë nga gjithë kjo shumë e shpenzuar është një roje sigurie tek dyert e godinave, ndërkojë që Universiteti i Tiranës ka më shumë pajisje dhe më shumë godina se dy të parët dhe shpenzon vetëm 4.404.109,00 lekë në vit për ruajtje dhe sigurim të ndërtesave.

Në nënkatgorinë Aktivitete sociale për personelin, Universiteti i Tiranës nuk ka bërë asnjë shpenzim ndërsa ai i Elbasanit ka shpenzuar vlerën 1,411,600 lekë. Për të dyja nënkatgoritë si mirëmbajtje ndërtesash ashtu dhe mirëmbajtje rrjetesh informatike është Universiteti i Elbasanit që ka shpenzuar vlerën më të madhe pasuar nga ai i Durrësit.

Kategori/Nënkategori	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
Sigurimi i shërbimeve	5.164.281,00	15.992.791,00	28.473.266,00
Posta dhe shërbimi korrier	139.068,00	25.962,00	42.354,00
Telefon dhe internet	601.502,00	248.394,00	513.654,00
Pastrim dhe gjelbërim			489.600,00
Shërbime të tjera transporti			22.990,00
Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	4.404.109,00	10.780.030,00	13.919.080,00
Shërbime të tjera			363.732,00
Aktivitete sociale per personelin		111.000,00	1.411.600,00
Mirëmbajtje ndërtesash	13.602,00	1.754.922,00	3.828.014,00
Instalim dhe mirembajtje rrjetesh informatike	6.000,00	1.051.629,00	7.882.242,00
Mirëmbajtje të tjera		2.020.854,00	

3.5 Kategoritë “Transferta dhe Subvencione” dhe “Të tjera”

Në kategorinë “Të tjera” ku janë përfshirë shpenzimet për bursa studimi si dhe shpenzimet gjyqësore shohim një anomali të theksuar të Universitetit të Tiranës, i cili nuk ka kryer asnjë transaksion për nënkatgorinë “Bursa Studimi”, ndërkohë që Universiteti i Durrësit ka kryer transaksione me vlerë 7,524,950 lekë dhe ai i Elbasanit transaksione me vlerë 19,069,884 lekë. Sic e përmendëm edhe më lart, ngërci midis Bordit të Administrimit dhe Rektoratit ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta edhe tek mungesa e bursave të studimit për studentët e ekselencës.

Ndërsa për kategorinë shpenzime gjyqësore, Universiteti i Tiranës ka shpenzuar më shumë, ekzaktësisht vlerën 39,268,777 lekë ndërsa ai i Durrësit vlerën 7,552,914 lekë. Universiteti i Elbasanit nuk ka asnjë transaksion të kryer në këtë nënkatgori. Shpenzimet në këtë kategori lidhen kryesisht me vendimet gjyqësore për largimet e padrejta nga puna. Ky është rasti kur keq-administrimi dhe papërgjegjshmëria e titullarëve rëndon mbi xhepat e studentëve pasi universiteti detyrohet të paguajë para nga tarifat e studentëve për të paguar punonjësit e larguar në mënyrë të padrejtë nga puna.

Kategori/Nënkatgori	Universiteti i Tiranes	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
Transferta dhe Subvencione	1.266.643,00	130.826,00	24.671,00
Tranferta për projekte		130.822,00	
Kuota Anëtarësimi	1.266.643,00		17.771,00
Komisione Bankare		4,00	6.900,00
Të tjera	39.268.777,00	15.047.864,00	19.069.884,00
Mbështetje e nxënësve të ekselencës dhe bursa studimi		7.524.950,00	19.069.884,00
Shpenzime gjyqësore	39.268.777,00	7.522.914,00	

4 Transparency e institucioneve të arsimit te lartë (IAL)

Qëndresa Qytetare monitoroi dhe testoi zbatimin e të drejtës së informimit nga ana e tre universitetave publike të përgjedhura duke dërguar 20 kërkesa për informacion dhe duke vëzhguar programet e tyre të transparencës.

Nga 20 kërkesat e dërguara, asnjë nga universitetet nuk ktheu një përgjigje brenda afatit, ndërsa Universiteti i Tiranës si përgjigje të katër kërkesave dërgoi një faturë në vlerën 1000 lekë të reja për ta paguar në këmbim të këtij shërbimi, me arsyetimin se neni 13 i ligjit për të drejtën e informimit i lejon të vendosë një tarifë të tillë në këmbim të informacionit.

FATURË PËR ARKËTIM

NR. _____ Date _____

BANKËS CREDINS

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka juaj të pranojë nga Klienti(Persona /Personë Fizikë/Persona Juridikë) arkëtime të të ardhurave , për llogari të institucionit tonë me emërtimet , kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i Institucionit	UNIVERSITETI I TIRANËS REKTORATI	
Kodi i Institucionit	1011039	
Kodi i Degës së Thesarit ku vepron	3535	
Emri i Paguesit		
Numri i Identifikimit të Paguesit		

ID e DETYRIMET	Përshtrimi i të ardhurave	Shuma që Arkëtohet
Tarifë për të drejtë informimi	7111099	1000 Lekë
TOTALI		

Institucioni: **Universiteti i Tiranës**

Klienti: _____

(Emrë Mbiemër) _____

Adresa: _____

Kontakti: _____

Së pari, neni 13 i ligjit për të drejtën e informimit përcakton se kostoja e kérkuar për kërkesat për informacion nuk duhet të kalojë koston fikse të materialeve që do printohen, së dyti, kur informacioni kërcohët me e-mail kostoja e shërbimit është 0, dhe së treti, informacioni që studientët kérkuan, ligjërisht duhet të ishte i shpallur në Programin e Transparencës.

Kjo tarifë vjen si rezultat i vendimit nr.60 "për tarifat" ku vetë rektorati ka përcaktuar shumën fikse për të dhënë informacion. Nga ana tjetër të treja universitetet nuk i janë përmbajtur respektimit të ligjit për të drejtën e informimit sa i përket informacioneve që duhet të

kishin publikuar në Programin e Transparencës, duke theksuar se edhe pyetjet që iu drejtuani universitetave nga studentët kishin të bënин me kategori informacioni që sipas ligjit duhet të ishin bërë vetë publike. Universitetet nuk kanë të shpallura informacionet mbi kontratat dhe prokurimet, vendimet e Bordeve të Administrimit me efekte financiare si dhe buxhetet dhe planet e investimeve.

5. Rekomandime



Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe prokuroria e rretheve duhet të ndërhyjë menjëherë nëpërmjet auditimit ligjor të universiteteve publike për të zbuluar shpenzimet abuzive, të pa justifikuara dhe të realizuara jashtë kategorive të parashikuara në buxhet.



Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Senatet Akademike dhe Këshillat Studentore të universiteteve të kërkojnë informacione të detajuara se si shpenzohen paratë, pse nuk investohet për shkencën dhe kush janë kontraktorët që përfitojnë paratë e tarifave të studentëve pa i kthyer në shërbime për ta.



Ministria e Arsimit, Sporit dhe Rinisë si autoriteti mbikqyrës i financave të universiteteve duhet të monitorojë dhe instruktojë skemën e shpërndarjes së të ardhurave në investime dhe shërbime sipas një manuali apo modeli të paracaktuar për të mos iu lënë vend abuzimeve me kontratat dhe prokurimet në disfavor të studentëve.



Rektorët e Universiteteve dhe Bordet e Administrimit të publikojnë vendimet dhe kontratat me palët e treta për cdo veprim finanziar si dhe të informojnë senatet dhe Këshillat Studentorë në lidhje me investimet e vitit akademik nëpërmjet procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masat e nevojshme administrative ndaj titullarëve që nuk publikojnë informacionet që i detyron ligji në programin e transparencës dhe të shqyrtojë dhe rregullojë nëpërmjet një udhëzimi vendosjen e tarifave për të drejtën e informimit në drejtim të institucioneve të arsimit të lartë.

Mediat dhe organizatat lokale duhet të përfshihen në monitorimin dhe pasqyrimin e aktivitetit finanziar të

6. Shtojca

6.1 Fishat e monitorimit të Programeve të Transparencës

Tematika	Indikatori	Publikuar/Jo e publikuar	Sektori i publikimit (linku)	Data e publikimit	Sqarim
1	Fq. web	Faqe zyrtare interneti	Po	uamd.edu.al	
2	PT	Programi i Transparencys	Po	Ne faqen zyrtare te universitetit,menuja SHERBIME-> PROGRAMI I TRANSPARENCES	Informacioni jetet ne pergjithesi,nuk hapen linket per informacion me te holesehem.
3	Koordinatori	Emri i Koordinatorit	Po	Programi i Transparencys http://www.uamd.edu.al/newuni/index.php/sq/programi-i-transparencies/	Ne disa raste jo i aksesueshem.
4		E-mail i koordinatorit	Po	Programi i Transparencys http://www.uamd.edu.al/newuni/index.php/sq/programi-i-transparencies/	Ne disa raste jo i aksesueshem.
5		Kontakti telefonik	Po	Programi i Transparencys http://www.uamd.edu.al/newuni/index.php/sq/programi-i-transparencies/	Ne disa raste jo i aksesueshem.
6	Struktura organizative	Adresa e zyrave	Po	Programi i Transparencys http://www.uamd.edu.al/newuni/index.php/sq/programi-i-transparencies/	
7		Orari i përtjes së kërkave/arkesave	Po	Programi i Transparencys http://www.uamd.edu.al/newuni/index.php/sq/programi-i-transparencies/	
8		Struktura organizative	Po	Programi i Transparencys http://www.uamd.edu.al/newuni/index.php/sq/programi-i-transparencies/	
9		Funksione dhe dytëra	Jo		
10		Arsimini dhe kualifikim	Jo		E shtet e parashikuar te publikohet nga programi i transparencys por nuk ka link siç është.
11		Pagat	Jo		E rrejtë gje.
12	Transparencës së shërbimit ndaj publikut	Regjistri i kërkave	Jo		E rrejtë gje.
13		Regjistri i përgjigjeve	Jo		E rrejtë gje.
14		Shërbimet	Po	Faqja zyrtare e universitetit,menuja SHERBIME	
15		Sistem dokumentacioni	Jo		
17	Aspekti ligjor	Konventa	Po		Jo kur kerkojme ne faqen zyrtare po e gjendshme ne 2017 forme dokumenti ne Google.
18		Lige dhe akte			
19		Rregullore	Po	https://www.uamd.edu.al/new/multimedia/rregulloja_UAMD.pdf	
		Vendime të Senait	Jo		
		Vendime të Rektorit	Po		Disa vendime te gjendshme kur kerkojme ne internete dhe jo tek faqja zyrtare e universitetit.
		Vendime te Bordit te Administrimit	Jo		
20		Procedura	Jo		
21		Kodi i etikës	Jo		
22	Financat	Buxhet dhe plan shpenzimesh	Po		Vetem i vitit 2015
23		Prokurime	Jo		Nuk funksionon linku.
		Raporte monitorimi financiar	Jo		
24		Kontratat të lidhura	Jo		
25	Studentët	Kategoritë që përfitojnë bursa	Po	http://www.uamd.edu.al/newuni/index.php/sq/bursa/	
26		Rregullore për Ksworthillat Studentore			
27		Procedurat për transferim studimesh	Po	http://www.uamd.edu.al/media/users/4/RREGULLORE_TRANSFERIMI_BBEDINI.pdf	

6.2 Përgjigje zyrtare e Universitetit të Tiranës me tarifat përkatëse

**are
it të
orifat**

Nr. 59-K/Prot.

Lënda:

Jepet dokumentacioni i kërkuar

Z. RIGELS XHEMOLLARI

Tiranë më 05.04.2018

Adresa: Rr. Hoxha Tahsin, Pall. Vjero,
Ap. 23/A, Tirane,
e-mail: qendresaqytetare@gmail.com
tel: 0692203074

Tiranë

Në ciliçinë e kërkuesit keni depozitar përmes Universitetit të Tiranës, në përpunje me nenin 11 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", kërkesën për dhënë informacioni, regjistruar me numër rendor 59-K, datë 21.03.2018 (sipas regjistrit përkatesë të kërkuesve dhe përgjigjeve).

Pas shqyrtimit të kërkuesës, mbi informacionin e kërkuar përmes buxhetin e viti 2017 ju informojme se bazuar në nenin 11 dhe nenin 13 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" si dhe në Vendimin nr. 60 datë 16.10.2015 "Për miratimin e tarifave" lutemi të kryeni pagesën sipas faturës bashkëlidhur, në mënyrë që të realizohet shërbimi i kërkuar.

Sa i përket kërkuesës së dyti, mbi planifikimin e të ardhurave përmes buxhetin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin 2018, ju informojmë se ende nuk është miratuar buxheti i këtij viti kalendari.

FATURË PËR ARKËTIM

NR. _____ DATE _____

BANKËS CREDINS

Me anë të kësaj faturë kërkojmë që Banka juaj të pranoj nga Klienti/Persuna /Personja Fizike/Personja Juridikë arkëtime të të ardhurave , përmes logartës institucionit tonë me emrëtimet , kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i Institucionit	UNIVERSITETI I TIRANËS REKTORATI
Kodi i Institucionit	101039
Kodi i Dëgës së Thesarisit ku vepron	3535
Emri i Paguesit	
Numri i identifikimit të Paguesit	

ID DETËVIMET	Pershkrimi i të ardhurave	Shuma që Arketohet
Emërtimi	Kodi i logarisë ekonomike	
Tarife përmes drejtë informimi	7111099	1000 Lekë
TOTALI		


Institucioni
Universiteti i Tiranës

Klienti

(Emr Mbiemrë)
Adresa
Kontakti


REKTORI
PROF.DR. M. NYRKONI

6.3 Vendim i Këshillit të Administrimit të Universitetit të Tiranës "Për tarfiat"



Përfa	Emisione
Tarifë Usqiporin Video (av.igf) në Projektorin e Holli Tip Spot 10 min-1 orë	3.500 lekë/ënra
Ambiente të Brendshme dhe të Jashme për Promovime (Ame.Plas.Vodafone)	2.000 lekë/orë
Ambiente i Brendshme (koridor) për vendosje të Automaneve Zbuluese i Modave për Trajnimin e Mësuese nga Institucionet Publike si Arsimi të Lartë	10 lekë/orë * 24 orë * 30 dite
Zgjedhjet e Modave për Trajnimin e Mësuese	1000 lekë/është/është
Tarifa ndërkombëtare për Ligjt "Për të Drejtën e Informimit", kërkë përmes informacionit	300 lekë
Ka këtë që të kërkohet trajtimi për mbi 10 faqe materiale (përpunim discursi tekstopimi)	500 lekë
Kërkohet që të kërkohet trajtimi për mbi 10 faqe materiale (përpunim discursi tekstopimi)	1000 lekë
* Ngjashme te pilka 2 te nent 13 si ligji nr.119/2014, këto tarifa shko do të zgjidhen me 1000 lekë.	
* Ngjashme te pilka 2 te nent 13 si ligji nr.119/2014, këto tarifa shko do të zgjidhen me 1000 lekë.	
* Studentët do të përfundojnë falas shtëpia e tij me 1000 lekë.	

6.4 Ankimin ndaj refuzimit për dhënie informacioni ndaj Universitetit "Aleksandër Xhuvani"



ë) mosdërgimi i kërkësës për informim te një autoritet tjeter publik, brenda afatit të parashikuar në pikën 2, të nent 12, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë; g) mosnjoftimi i kërkësës i kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjeter dhe kontaktet e nevojshme i janë dërguar autoriteti tjeter, në kundërshtim me parashikimet e pikës 3, të nent 12, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë.

Për sa më sipër, përparr marries së vendimit, Komisioneri kërkon të trajtoni kërkësat dhe të vlerësoni dhënien e informacionit të kërkuar brenda datës 17.04.2018. Në rast mosverpimi nga ana juaj brenda afatit të përcaktuar (datë 17.04.2018), Zyra e Komisionerit do të vlerësojë mbi ndjekjen e procedurës së mëtejshme në përpunje me ninen 18 die 24 të ligjit nr. 119/2014.





Ekipi i projektit:

Drejtues i grupit të punës

● Rigels Xhemollari

Ekspert për Arsimin

● Ines Mulellari

Eksperte për të dhënat financiare

Monitotorues:

● Anda Hysi

Studente masteri, Fakulteti i Drejtësisë, UT

● Anxhela Musaj

Studente masteri, Fakulteti Filologjik, UT

● Amina Sinaj

Studente masteri, Fakultetit i shkencave të Natyrës, UT

● Anxebla Salaj

Studente masteri, Fakulteti i Ekonomisë,
Universiteti "Aleksandër Xhuvani"

● Elona Tutaj

Studente masteri, Fakulteti i Shkencave Sociale, UT

● Alketa Qosja

Studente masteri, Fakulteti i Drejtësisë, UT

● Albert Hysa,

Student masteri, Fakulteti Ekonomik,
Universiteti "Aleksandër Xhuvani"

Ky raport është pjesë e aktiviteteve të nismës "Monitorim i autonomisë dhe transparencës financiare së universiteteve publike" të ndërmarrë nga Qëndresa Qytetare me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung.



**QENDRESA
QYTETARE**



**TASK
FORCA
STUDENTORE**

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**